



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

DEPARTAMENTI I AKTEVE LIGJORE PRIORITARE
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NJËSIA E PROGRAMIMIT TË AKTEVE RREGULLATORE DHE RIA
DREJTORIA E NDIKIMIT RREGULLATOR

RAPORTI GJASHTËMUJOR I PERFORMANCËS PËR KONSULTIMET PUBLIKE

QENDRA E QEVERISJES

KORRIK 2024

<u>1. HYRJE.....</u>	<u>4</u>
<u>2. FREKUENCA E KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PROJEKTLIGJET DHE PROJEKT-STRATEGJITË</u>	<u>6</u>
<u>3. NUMRI I KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PROJEKTLIGJET ME VNR DHE NDIKIMI I KONSULTIMEVE PUBLIKE NË RAPORTET VNR</u>	<u>7</u>
<u>4. PËRDORIMI I PËRJASHTIMEVE NGA KONSULTIMET PUBLIKE PËR AKTET NË PROGRAMIN ANALITIK, PLANIN KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN DHE DOKUMENTE STRATEGJIKE SEKTORIALE</u>	<u>8</u>
<u>5. KOHËZGJATJA E KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PROJEKTLIGJET, DOKUMENTET STRATEGJIKE DHE TË POLITIKAVE</u>	<u>10</u>
<u>6. PËRDORIMI I REGJISTRIT ELEKTRONIK PËR NJOFTIMET DHE KONSULTIMET PUBLIKE PËR KONSULTIMET E PROJEKTLIGJEVE DHE PROJEKTSTRATEGJIVE</u>	<u>11</u>
<u>7. ORGANIZIMI I TAKIMEVE PUBLIKE TË KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJET DHE PROJEKTSTRATEGJITË</u>	<u>12</u>
<u>8. SHKALLA E PËRFSHIRJES SË AKTORËVE TË JASHTËM JOQEVERITARË NË HARTIMIN APO KONSULTIMET E PROJEKTLIGJEVE, PROJEKTSTRATEGJIVE DHE DOKUMENTEVE TË POLITIKAVE SI ANËTARË TË GRUPEVE TË PUNËS/ORGANEVE KONSULTATIVE</u>	<u>14</u>
<u>9. NUMRI I PJESËMARRËSVE OË KONTRIBUOJNË NË KONSULTIMET PUBLIKE PËR PROJEKTLIGJET DHE PROJEKTSTRATEGJITË ME KOMENTET DHE REKOMANDIMET E TYRE</u>	<u>16</u>
<u>11. SHKALLA E PRANIMIT TË KONTRIBUTEVE TË PALËVE TË INTERESIT NË PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJET DHE PROJEKTSTRATEGJITË.....</u>	<u>19</u>
<u>12. CILËSIA E PERFORMANCËS INSTITUCIONALE NË ZBATIMIN E KONSULTIMEVE PUBLIKE</u>	<u>21</u>
<u>13. SHKALLA E REALIZMIT TË PLANIT VJETOR TË KONSULTIMIT PUBLIK ..</u>	<u>23</u>

**14. PËRDORIMI I REGJISTRIT ELEKTRONIK TË NJOFTIMIT DHE
KONSULTIMIT PUBLIK..... 23**

15. GJETJET KRYESORE DHE REKOMANDIMET 24

1. Hyrje

Konsultimi publik është një nga instrumentet kryesore rregullatore të përdorura për të përmirësuar transparencën, efikasitetin dhe efektivitetin në procesin e hartimit të legjislacionit dhe politikave publike, bazuar në të dhëna dhe në vlerësimet mbi ndikimin rregullator.

Konsultimi publik është mekanizmi që mundëson përfshirjen e publikut, grupeve të interesit, biznesit, komunitetit akademik, ekspertëve dhe medias në vendimarrje duke siguruar përfshirjen e tyre gjatë gjithë procesit të politikëbërjes, me qëllim krijimin e politikave të cilat janë me cilësi të lartë në përmbajtje, që reflektojnë nevojat e shoqërisë dhe që sigurojnë zhvillim.

Baza ligjore e zhvillimit të procesit të konsultimit publik është ndër më të avancuarat dhe sipas standardeve të Bashkimit Evropian. Standardizimi i procesit të konsultimit publik është i bazuar në ligjin nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe në urdhrin nr.3, datë 29.1.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrisë, “Për miratimin e udhëzuesit të konsultimit publik”.

Departamenti i Akteve Ligjore Prioritare të Këshillit të Ministrave udhëheq, monitoron dhe përgatit raportprogresin e qendrës së qeverisjes për konsultimin publik në mënyrë periodike dhe e bën atë publik në përmbushje të detyrimeve ligjore të parashikuara.

Konsultimi publik është një komponent i rëndësishëm i cluster-it të parë negociues për procesin e integritimit evropian. Ky proces lidhet ngushtësisht jo vetëm me funksionimin e administratës publike, por dhe me funksionimin e institucioneve demokratike.

Me qëllim adresimin e rekomandimeve nga procesi screening, por dhe përforcimin e kulturës mbi procesin, konsultimi publik është integruar në udhërrëfyesit respektivë të lidhur me Refomën e Administratës Publike dhe Funksionimin e Institucioneve Demokratike 2023 - 2030. Sigurimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse për fuqizimin e shoqërisë civile dhe rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së institucioneve janë në themel të masave të ndërmarra për të ardhmen.

Departamenti i Akteve Ligjore Prioritare të Këshillit të Ministrave, në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për përmirësimin dhe promovimin e këtij procesi, dhe në zbatim të rekomandimit VI të GRECO-s, ka mundësuar publikimin e projektakteve me interes të lartë publik edhe në faqet online të ministrive të linjës, sikurse në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik.

Procesi i hartimit të raportit u zhvillua në dy faza: në fazën e parë, ministritë përgatitën dhe konsoliduan raportet sektoriale me të gjitha të dhënat analitike të kërkuara, me mbështetjen e Departamentit të Akteve Ligjore Prioritare të Këshillit të Ministrave, në Kryeministri, dhe në fazën e dytë nisi procesi i përgatitjes së raportit vjetor të performancës së qendrës qeverisëse, duke marrë parasysh të gjitha të dhënat analitike të mbledhura nga raportet e ministrive të linjës.

Ministrive, gjatë përgatitjes së raporteve të tyre, u është siguruar vazhdimisht mbështetje nga Departamenti i Akteve Ligjore Prioritare të Këshillit të Ministrave. Komentet janë përgatitur për çdo draft raport sektorial, me qëllim përmirësimin e cilësisë. Gjithashtu, ata janë asistuar nga Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit lidhur me procesin e publikimit të raporteve në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

Për secilin nga treguesit e performancës së vlerësuar në këtë raport janë dhënë shpjegime metodologjike, pasuar nga përmbledhja e gjetjeve kryesore për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024.

Vlerësimi fillon me një përmbledhje të performancës institucionale të ministrive për sa i përket sasisë (frekuencës) së konsultimeve publike, gjithashtu në lidhje me përdorimin e përjashtimeve për aktet e parashikuara në programin analitik, PKIE dhe dokumentet strategjike sektoriale, duke ofruar si fillim informacion mbi kornizën e përgjithshme dhe lidhjen me konsultimin publik të këtyre dokumenteve të rëndësishëm të planifikimit.

Raporti vijon me vlerësimin e cilësisë së procesit të konsultimeve, e cila përfshin një seri treguesish në lidhje me kohëzgjatjen e konsultimeve publike, përdorimin e Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, organizimin e takimeve publike, metodat e përzgjedhura të konsultimit publik, shkallën e përfshirjes së aktorëve të jashtëm joqeveritarë si anëtarë të grupeve të punës/organeve konsultative, në hartimin ose konsultimet e projektligjeve, dokumenteve strategjike dhe të politikave; numrin e pjesëmarrësve që kontribuojnë në konsultimet publike; raportimin për rezultatet e konsultimeve, si edhe shkallën e pranimit të kontributeve të palëve të interesit në procesin e konsultimit publik.

Vijimësia dhe kuptueshmëria e konsultimeve publike në raportet e VNR-së janë adresuar në raport së bashku me konkluzionet dhe rekomandimet kryesore. Së fundi, raporti prezanton pasaportën e indikatorëve dhe ecurinë e realizimit të tyre, së bashku me performancën e institucioneve për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024.

2. Frekuenca e konsultimeve publike për projektligjet dhe projekt-strategjitë

Formula e mëposhtme e llogaritjes përdoret për indeksin e frekuencës së konsultimit publik (IFPC) për projektligjet dhe projekt-strategjitë:

$$\text{IFPC} = \frac{\text{Numri i projektligjeve, projekt-strategjive dhe dokumenteve të politikave të miratuara përmes procesit të konsultimit publik gjatë një viti}}{\text{Numri total i projektligjeve, dokumenteve strategjike dhe të politikave të miratuara nga qeveria që duhet të paraqiteshin për konsultim publik}} \times 100$$

Në llogaritjen e numrit të përgjithshëm të projektligjeve dhe të projekt dokumenteve të strategjive dhe politikave të miratuara nga qeveria, që duhet të paraqiteshin për konsultim publik, duhet të merren parasysh dispozitat e nenit 1, të ligjit nr.146/2014, për njoftimin dhe konsultimin publik –ku parashikohet se aktet që i nënshtrohen konsultimit publik janë: 1) projektligjet dhe 2) projektvendimet që miratojnë dokumente strategjike dhe politika me interes të lartë publik.

Përveç kësaj, aplikohen dhe përjashtimet nga konsultimi publik të parashikuara nga neni 4, i ligjit për konsultimin publik, përkatësisht:


- Çështjet e sigurisë kombëtare, për sa kohë që ato përbëjnë sekret shtetëror, në përputhje me ligjin për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”;
- Marrëveshjet ndërkombëtare, marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale;
- Aktet individuale administrative dhe aktet normative administrative, përveçse kur parashikohet ndryshe nga një ligj i posaçëm;
- Aktet normative, me fuqinë e ligjit të miratuar nga Këshilli i Ministrave;
- Emergjencat civile.

Pasi aplikohen përjashtimet e nevojshme, numri i përgjithshëm i akteve për të cilat kërkohet kryerja e konsultimeve publike është **32, prej të cilave 30 i janë nënshtuar këtij procesi nëpërmjet të paktën një prej metodave të tij.**

Kjo e bën **indeksin e përgjithshëm të frekuencës së konsultimeve publike për gjashtëmuorin e parë të vitit 2024 të rezultojë: 93,75%.**

Rezultati i indeksit për gjashtëmuorin e parë të vitit 2024 krahasuar me ciklin e plotë vjetor 2023 (**92,18%**), paraqitet me një rritje prej **1,7%**.

Grafik 1: Frekuenca e Konsultimeve Publike 2020 - 6MI 2024



Rezultati i indeksit të konsultimeve publike për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024 është më i larti i arritur ndonjëherë. Shqipëria, bazuar në raportin vjetor të SIGMA/OECD për Parimet e Administratës Publike 2021, konsiderohet si vendi me performancën me të lartë në rajon.


3. Numri i konsultimeve publike për projektligjet me VNR dhe ndikimi i konsultimeve publike në raportet VNR

Ky tregues përllorarit numrin e projektligjeve me VNR të cilat i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik, përkundrajt numrit të përgjithshëm të projektligjeve për të cilat është hartuar VNR.

Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024, u miratuan dhe konsultuan **20** projektligje të cilat i nënshtrohen procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator (VNR). **Indeksi për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024 është 100%**, në të njëjtat nivele me vitet pararendës 2023 dhe 2022.

Për 6 nga këto projektligje raporti VNR është ndryshuar bazuar në informacionin dhe të dhënat e marra gjatë konsultimit publik. Indeksi i ndryshimit të raporteve VNR bazuar në rezultatet e konsultimit publik, **30%**.

Grafik 2: Konsultimi publik për projektligjet me VNR 2020 - 6MI 2024



4. Përdorimi i përjashtimeve nga konsultimet publike për aktet në programin analitik, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian dhe dokumente strategjike sektoriale

Përjashtimet nga konsultimet publike për aktet në programin analitik

Ky tregues mat frekuencën e përdorimit të përjashtimeve nga konsultimet publike (kriteret e përjashtimit të përmendura në nenin 4, të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik) për aktet e parashikuara në planin vjetor legjislativ të qeverisë (Programi analitik). Ai matet si përqindje e akteve të parashikuara në programin analitik, për të cilat janë përdorur përjashtime nga konsultimet publike, sipas përcaktimeve të nenit 4, të këtij ligji, ku dispozitat e ligjit nuk zbatohen gjatë proceseve të vendimmarrjes në lidhje me:


- çështjet e sigurisë kombëtare, për sa kohë që ato përbëjnë një sekret shtetëror, në përputhje me ligjin për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”;
- marrëveshjet ndërkombëtare, marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale;
- aktet administrative individuale dhe aktet normative administrative, përveç rasteve kur me një ligj specifik parashikohet ndryshe;
- aktet normative, me fuqinë e ligjit të miratuar nga Këshilli i Ministrave;
- emergjencat civile;
- raste të tjera të përjashtimit të parashikuara nga ligji.

Bazuar në vendimin nr. 790, datë 28.12.2023, “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2024”, 267 projektakte janë parashikuar të miratohen për vitin 2024. Dispozitat përjashtuese nga procesi i

konsultimit publik, të nenit 4, të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, aplikohen për 177 akte.

Indeksi i përdorimit të përjashtimeve nga konsultimi publik për akte në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve 2024 është 66,29%. Krahasuar me indeksin e vitit 2023, i cili ishte **71,36 %** rezulton një tendencë me ulje e aplikimit të kriterëve përjashtuese.

Grafik 3: Aktet në total në PPAP në nivel krahasueshmërie



Përdorimi i përjashtimeve nga konsultimi publik për aktet në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian

Ky tregues mat frekuencën e përdorimit të përjashtimeve nga konsultimi publik (kriteret e përjashtimit të përmendura në nenin 4, të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik) për aktet e parashikuara në Planin Kombëtar për Integritimin Evropian (PKIE). Ai matet si përqindje e akteve të parashikuara në PKIE, për të cilat janë përdorur përjashtime nga konsultimi publik (kriteret e përjashtimit sipas nenit 4).

Në Planin Kombëtar për Integritimin Evropian 2024-2026 janë parashikuar 102 projektligje dhe vendime të Këshillit të Ministrave, të cilat përbëjnë filtrin e parë të akteve mbi të cilat aplikohen kriteret e përjashtimit, të përcaktuara në nenin 4, të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik

Indeksi i përdorimit të përjashtimeve nga konsultimi publik për aktet e parashikuara në Planin Kombëtar për Integritimin Evropian (PKIE) është për 68 akte ose 67%.

Përdorimi i përjashtimeve nga konsultimi publik për aktet në dokumentet strategjike sektoriale

Ky tregues mat frekuencën e përdorimit të përjashtimeve nga konsultimi publik (kriteret e përjashtimit të përcaktuara në nenin 4, të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik) për aktet e parashikuara në dokumentet strategjike sektoriale. Ai matet si përqindje e akteve të parashikuara

në dokumentet strategjike sektoriale, për të cilat janë përdorur përjashtime nga konsultimi publik (kriteret e përjashtimit sipas nenit 4).

Për vitin 2024 rezulton që ministrinë kanë planifikuar miratimin e 97 akteve, të cilat lidhen me dokumente strategjike kombëtare/sektoriale. Duke aplikuar kriteret e përjashtimit, rezulton që për 90 akte të parashikuara në dokumentet strategjike janë përdorur kriteret e përjashtimit përcaktuar në nenin 4.

Indeksi i përdorimit të përjashtimeve nga konsultimi publik për aktet në dokumentet strategjike sektoriale në gjashtëmuorin e parë të vitit 2024 është 92,78%. Tendencë në rritje krahasuar me vitin 2023, 75,89%.

5. Kohëzgjatja e konsultimeve publike për projektligjet, dokumentet strategjike dhe të politikave

Ky tregues paraqet të dhënat në lidhje me kohëzgjatjen minimale të konsultimeve publike për projektligjet dhe projektstrategjitë, të parashikuara në ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik. Ai mat përqindjen e projektligjeve, projektdokumenteve strategjike dhe të politikave të konsultuara, për të cilat konsultimi publik ka zgjatur të paktën 20 ditë pune. Formula e mëposhtme përdoret për llogaritjen e indeksit të respektimit të kohëzgjatjes së konsultimit publik (IPCDC) për projektligjet, projektdokumentet strategjike dhe të politikave.

$$\text{IPCDC} = \frac{\text{Numri i projektligjeve dhe projektstrategjive të konsultuara në një vit, për të cilat konsultimi publik ka zgjatur të paktën 20 ditë pune}}{\text{Numri total i projektligjeve dhe projektstrategjive të konsultuara}} \times 100$$

Nga **29 akte** të konsultuara gjithsej nëpërmjet RENJKP, për **27 akte** konsultimet publike kanë zgjatur të paktën 20 ditë pune.

Indeksi i respektimit të Kohëzgjatjes së Konsultimit Publik (IPCDC) për projektligjet, projektstrategjitë dhe dokumentet e politikave është 93% dhe paraqitet me rritje krahasuar me vitin 2023.

Kohëzgjatja “20 ditë pune” është afati ligjor për publikimin e akteve në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike. Ndërkohë që procesi i konsultimit nëpërmjet metodave të tjera si: organizimi i takimeve konsultative, dëgjesat publike, tryezat me aktorë të interesit, komunikimet me e-mail dhe shkresat zyrtare, zhvillohet që në fazat e hershme të hartimit të aktit deri në hartimin e draftit të avancuar, i cili më pas paraqitet për miratim. Në varësi të kompleksitetit

dhe rëndësisë së nismës ligjore, institucionet përzgjedhin metodat dhe kohëzgjatjen për zhvillimin e konsultimeve publike.

Grafik 4: *Indeksi IRKKP % e akteve të konsultuara duke zbatuar afatin minimum ligjor*



6. Përdorimi i Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për konsultimet e projektligjeve dhe projektstrategjive


Ky tregues paraqet të dhëna lidhur me përdorimin e Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për kryerjen e konsultimeve publike mbi projektligjet dhe projektstrategjitë. Treguesi paraqet përqindjen e projektligjeve të konsultuara, projektdokumenteve strategjike dhe të politikave për të cilat janë kryer konsultimet publike, përmes Regjistrimit Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENJKP).

Formula e mëposhtme përdoret për llogaritjen e indeksit të përdorimit të Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (IERNPC) për kryerjen e konsultimeve publike mbi projektligjet dhe projektstrategjitë. Raporti i projektligjeve dhe projektstrategjive të konsultuara, për të cilat u kryen konsultimet publike përmes RENJKP-së:


$$\text{IERNPC} = \frac{\text{Numri i projektligjeve dhe i projektstrategjive të konsultuara përmes RENJKP-së}}{\text{Numri total i projektligjeve dhe projektstrategjive të konsultuara (gjatë një viti)}} \times 100$$

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, **29 nga 30 akte të konsultuara janë publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike ose 97%** e të gjitha akteve të konsultuara. Projektvendimi “Për miratimin e Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2024 – 2026”, i propozuar nga Ministria e Financave nuk është publikuar në RENJKP. Megjithatë ky projektligj i është nënshtruar një procesi të zgjeruar konsultimi publik me aktorët e interesit për një periudhë disa mujore.

Grafik 5: Raporti i akteve të konsultuara dhe të publikuara në RENJKP në nivel krahasueshmërie



Grafik 6: Përdorimi i Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike 2020 –6MI 2024



7. Organizimi i takimeve publike të konsultimit publik për projektligjet dhe projektstrategjitë

Formula e mëposhtme përdoret për llogaritjen e indeksit të frekuencës së organizimit të takimeve publike (IPM) si mjet për konsultimin e projektligjeve, projektdokumenteve strategjike dhe të


politikave - përqindja e projektligjeve dhe projektstrategjive të konsultuara për të cilat janë organizuar takime publike gjatë periudhës së hapur për konsultime:

$$\text{IPM} = \frac{\text{Numri i projektligjeve dhe i projektstrategjive të konsultuara në një vit, për të cilat janë organizuar takime të konsultimit publik}}{\text{Numri total i projektligjeve dhe i projektstrategjive të konsultuara}} \times 100$$

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, nga **30 akte të konsultuara gjithsej, për konsultimin e 21 prej tyre janë organizuar takime publike. Indeksi i frekuencës së organizimit të takimeve publike (IPM) është 70%.**


Frekuenca e zhvillimit të takimeve konsultative, si një nga metodat kryesore të konsultimit, përcakohet nga kompleksiteti i nismës ligjore të propozuar në përmbushje edhe të një prej parimeve bazë të procesit të konsultimit publik. Digjitalizimi i procesit është një faktor që ndikon në trendin e zhvillimit të takimeve, pasi aktorët e interesit marrin njoftime automatike për publikimet për konsultim. Megjithatë, rezultoni që metodat e përzgjedhura kanë siguruar një proces cilësor dhe efektiv konsultimi publik për aktet e miratuara përgjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, objekt i procesit të konsultimit publik.

Grafik 7: Indeksi i frekuencës së organizimit të takimeve publike 2020 - 6MI 2024




Përveç publikimeve në regjistrin elektronik dhe takimeve publike, janë përdorur dhe metoda të tjera konsultimi si: publikimi në faqet zyrtare të internetit të ministrive, posta elektronike, këshillat konsultativ dhe forma të tjera. Më poshtë është përmbledhja e përdorimit të metodave të ndryshme të konsultimeve publike me numrin e akteve për të cilat janë përdorur këto metoda të konsultimeve.

Grafiku 8: Përdorimi i metodave të ndryshme të konsultimeve, 6MI 2024



Frekuenca e përdorimit të metodave të ndryshme të konsultimeve publike me numrin e akteve për vitet 2020-6MI 2024, paraqitet si më poshtë vijon:

Grafiku 9: Përdorimi i metodave të konsultimit publik në nivel krahasueshmërie 2020 - 6MI 2024



- Shkalla e përfshirjes së aktorëve të jashtëm joqeveritarë në hartimin apo konsultimet e projektligjeve, projektstrategjive dhe dokumenteve të politikave si anëtarë të grupeve të punës/organeve konsultative

Përfshirja sa më e madhe e aktorëve të jashtëm joqeveritarë në hartimin ose konsultimet për projektligjet, dokumentet strategjike dhe të politikave si anëtarë të grupeve të menaxhimit të integruar të politikave/organeve konsultative tregon hapjen dhe gjithëpërfshirjen e fazës së hershme të formulimit të politikave, që shpesh ofron potencialin më të madh për ndikim të palëve të interesuara për përmbajtjen e drafteve të politikave dhe të nismave ligjore.

Qëllimi i këtij treguesi është të ndjekë trendet në numrin e aktorëve të jashtëm joqeveritarë si anëtarë të emëruar të grupeve të menaxhimit të integruar të politikave/organeve konsultative për hartimin e akteve të reja përmes një formule:

IËG= Numri i aktorëve joqeveritarë të përfshirë në hartimin dhe/ose konsultimet për projektligjet dhe strategjitë si anëtarë të emëruar të grupeve të menaxhimit të integruar/organeve konsultative.

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, institucionet raportuan **81** aktorë të jashtëm joqeveritar të përfshirë në hartimin e projektligjeve dhe projektstrategjive si anëtarë të emëruar të grupeve të menaxhimit të integruar të politikave, organeve konsultative (GP) dhe ekspertë.

Ky numër konsiderohet relativisht i lartë, pasi përfshin vetëm aktorët joqeveritarë duke lënë jashtë përlllogaritjes anëtarët përfaqësues të institucioneve shtetërore.

Nuk konstatohet trend rënës krahasuar me periudhat e mëparshme, ndonëse numri i raportuar është më i ulët. Ky ndryshim vjen për shkak të ndryshimit të mënyrës së raportimit lidhur me hartimin e PKIE, nga viti 2023, ku anëtarët e GNPIE të cilët kontribuojnë në hartimin e këtij dokumenti nuk përlllogariten më si aktorë të jashtëm, por si një mekanizëm i vetëm dhe unik për këtë proces.

Tabela 1: *Numri i palëve të interesit në grupet e menaxhimit të integruar/organet konsultative në ministrinë e linjës*

Titulli i aktit	Numri i aktorëve të jashtëm, jo-qeveritarë , anëtarë të organeve këshillimore apo të grupeve të punës të hartimit të akteve
Për sigurinë kibernetike	2
Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar	9
Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2016, “Për prefektin e qarkut”.	1
Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë.	10
Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024 – 2030 dhe të Planit të Veprimit në zbatim të saj	2

Propozimin e projektligjit “për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2014, “për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar”	12
“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar””	9
Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji	8
Për disa ndryshime në ligjin nr.162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, të ndryshuar.	1
Për disa ndryshime në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar.	1
Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar.	1
Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar.	1
Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.	1
Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj 2024-2027.	1
Për miratimin e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike	7
Për Policinë e Shtetit.	4
“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10465, 2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.	9
Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012 "Për peshkimin", të ndryshuar.	2


9. Numri i pjesëmarrësve që kontribuojnë në konsultimet publike për projektligjet dhe projektstrategjitë me komentet dhe rekomandimet e tyre

Ky tregues (*IPARTICIP*) mat numrin e pjesëmarrësve (aktorë të jashtëm joqeveritarë) që kanë kontribuar në konsultimet publike për projektligjet dhe projektstrategjitë me komentet dhe rekomandimet e tyre përmes metodeve të ndryshme si: regjistri elektronik, takimet publike, komunikimi elektronik, këshillat konsultativë, Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave etj. Ky është një tregues i rëndësishëm i cilësisë së komunikimit dhe shtrirjes së procesit të konsultimit publik.

Për gjashtëmuorin e parë të vitit 2024, **ministritë raportuan 945 pjesëmarrës në konsultime publike** përmes metodave të ndryshme të konsultimit, **ndërsa 108 prej tyre kontribuan me komente dhe reagime.**


Treguesi (*IPARTICIP*) për gjashtëmuorin e parë të vitit 2024 rezulton **108**.

Grafiku 10. Numri i pjesëmarrësve kontribues në konsultimet publike 2020 – 6MI 2024




Pjesëmarrës kontribues në konsultimet publike me komentet e tyre përbëjnë **11%** të të gjithë pjesëmarrësve. Më poshtë paraqitet një pasqyrë e numrit të kontribuesve në konsultimet publike sipas institucioneve.

Grafiku 11: Numri i pjesëmarrësve kontribues në konsultimet publike në 6MI 2024



Në procesin e konsultimit publik për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024, u përfshinë **945** palë të interesuara nëpërmjet pjesëmarrjes në takime publike, dëgjesa, tryeza me prezence fizike dhe takime online.

Grafik 12: Numri i pjesëmarrësve në konsultimet publike në 6MI 2024



10. Raportimi mbi rezultatet e konsultimeve, nivelin e reagimit institucional ndaj komenteve/rekomandimeve të marra për konsultimet publike të projektligjeve dhe të projektstrategjive


Ky tregues mat shkallën e reagimit institucional ndaj komenteve dhe rekomandimeve të marra për konsultimet publike për projektligjet dhe projektstrategjitë. Treguesi matet përmes përqindjes së projektligjeve dhe projektstrategjive të konsultuara, për të cilat janë publikuar raportet për rezultatet e konsultimeve publike, në raport me numrin e përgjithshëm të projektligjeve dhe projektstrategjive të konsultuara.

$$IRESPONSE = \frac{\text{Numri i projektligjeve dhe projektstrategjive të konsultuara për të cilat janë publikuar raporte të rezultateve të konsultimeve publike}}{\text{Numri total i projektligjeve dhe i projektstrategjive të konsultuara}} \times 100$$

Për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024, për të gjitha aktet e konsultuara nëpërmjet RENJKP (29) janë përgatitur dhe publikuar raporte për rezultatet e konsultimeve publike. **Indeksi IRESPONSE për periudhën është 100%.**

Indeksi IRESPONSE është në rritje në raport me vitet e mëparshme.

Grafik 13 – Shkalla e reagimit institucional 2019 – 6MI 2024



11. Shkalla e pranimit të kontributeve të palëve të interesit në procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projektstrategjitë

Ky tregues mat ndikimin e pjesëmarrjes së publikut në kuadër të pranimit të kontributeve të palëve të interesit në konsultimet publike për projektligjet dhe projektstrategjitë (përmes çdo metode - Regjistri Elektronik, takimet publike, posta elektronike, këshillat konsultativë, etj). Treguesi matet përmes përqindjes së numrit të përgjithshëm të komenteve/rekomandimeve të marra nga palët e interesuara, që janë pranuar nga ministritë/organet qeveritare. Për qëllim të matjes më integrale të këtij treguesi merren parasysh komentet/rekomandimet plotësisht dhe pjesërisht të pranuar.


Ky tregues llogaritet duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$IACCEPT = \frac{\text{Numri i komenteve të pranuar plotësisht} + \text{numri i komenteve të pranuar pjesërisht për projektligjet dhe projektstrategjitë}}{\text{Numri total i komenteve të marra}} \times 100$$

Numri i përgjithshëm i komenteve të pranuar plotësisht dhe të pranuar pjesërisht për projektligjet dhe projektstrategjitë e konsultuara në **gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 është 231**. Kur pjesëtohen me numrin e përgjithshëm të komenteve të marra **450**, shkalla e pranimit të kontributeve të palëve të interesit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 është **51%**.


Nga 450 komente të marra, 184 komente janë pranuar plotësisht, 47 janë pranuar pjesërisht dhe 219 janë refuzuar.

Grafik 14 – Pasqyra e shkallës së pranimit të komenteve të palëve të interesit, 6MI 2024




Përgjatë vitit 2023 u shënua numri më i lartë i komenteve të mbledhura në procesin e konsultimit publik në krahasim me vitet e mëparshme. Duke konsideruar numrin e akteve të konsultuara që pritet të miratohen deri në fund të vitit 2024, trendi parashikohet konstant.

Grafik 15: Shkalla e pranueshmërisë së komenteve gjatë konsultimit publik në nivel krahasueshmërie 2020 – 6MI 2024



Grafik 16– Pasqyra e pranimit të komenteve të palëve të interesit në nivel krahasueshmërie



12. Cilësia e performancës institucionale në zbatimin e konsultimeve publike

Indeksi i cilësisë së performancës institucionale në zbatimin e konsultimeve publike vlerëson nivelin e informacionit të siguruar nga ministritë për përmbushjen e kërkesave (kritereve) të përcaktuara në ligjin nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, përkatësisht:

- Informacionin për publikimin e informacionit në sistemet qeveritare të informacionit (Regjistri elektronik dhe programi i transparencës);
- Konsultimet publike të mbajtura për të paktën 20 ditë pune;
- Grupet e palëve të interesit të përfshira në procesin e konsultimit;
- Raporti për numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të nxjerra, grupet e interesit dhe palët e interesuara të publikuara në regjistrin elektronik;
- Informacionin për komentet e pranuar reflektuara kundrejt komenteve të paraqitura të disponueshme në raport.

Metodologjia ndjek qasjen për matjen e cilësisë së konsultimeve publike të hartuar me mbështetjen e SIGMA-s, me qëllim monitorimin e progresit në përmbushjen e treguesve të përcaktuar në mbështetjen buxhetore për reformën e administratës publike dhe bazohet në të dhënat e raporteve për konsultimet publike të ministrive të mbledhura nga Kryeministria, si dhe të dhënat e mbledhura përmes RENJKP-së dhe *ëeb*-faqeve të internetit të ministrive.

Tabela 2 – Rezultatet– Cilësia e performancës institucionale në respektimin e standardeve të konsultimit publik

0	1	2	3	4
<i>Asnjë nga elementet nuk është përmendur</i>	<i>1-3 Pikë</i>	<i>4-5 Pikë</i>	<i>6-7 Pikë</i>	<i>8 Pikë</i>
Nuk është ofruar informacion për konsultimin publik.	Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar, por asnjë përfshirje e palëve të interesuara nuk ka ndodhur.	Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar për të paktën 20 ditë pune, asnjë raport mbi përfshirjen e palëve të interesit nuk është nxjerrë dhe nuk mbahen prova të mjaftueshme mbi reagimet e tyre.	Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar; raporti për përfshirjen e palëve të interesuara është nxjerrë dhe ruhen prova të mjaftueshme për reagimet e tyre por nuk ka informacion nëse reagimet janë reflektuar në draftin e ri.	Projektligjet publikohen në sistemin e informacionit qeveritar; sigurohet informacion i mjaftueshëm për konsultime të gjera me palët e interesit; ruhen prova të mjaftueshme për reagimet e tyre; një shkallë e mirë e reflektimit të reagimeve të palëve të interesuara pasqyrohet në draftin e ri.

Ky indeks është llogaritur në përputhje me një tabelë pikësh me shkallë vlerësimi nga 0-8, ku 32 akte të miratuara për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024, objekt i konsultimit publik kanë marrë pikët siç përshkruhet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3: *Pikët e cilësisë së konsultimeve publike për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024*


Numri i akteve	Pikët	Totali
27 akte	8 pikë	216
1 akt	7 pikë	7
1 akt	5 pikë	5
3 akte	0 pikë	0
Total (32 akte)		228 pikë total
Indeksi i cilësisë së performancës institucionale në respektimin e kërkesave të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik		7.12

Me rezultatin prej **7,12 për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024** konstatohet indeksi më i lartë për cilësinë e arritur ndonjëherë për procesin e konsultimit publik.

Ky rezultat i arritur për periudhën lidhet kryesisht me rritjen e kontrollit të cilësisë për procesin nga njësia përgjegjëse në Kryeministri, monitorimi dhe prezantimi i rezultateve të konsultimit publik në mbledhjet javore të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe niveleve të tjera teknike, si dhe si rezultat i rritjes së llogaridhënies nga institucionet qendrore.

Vlen të theksohet që koordinatorët e konsultimit publik luajnë rol të pazëvendësueshëm në sigurimin e rezultateve lidhur me konsultimin publik. Ndjekja dhe zbatimi me rigorozitet jo vetëm i procedurave dhe i standardeve të procesit, por dhe raportimit të duhur përbëjnë garancinë për suksesin lidhur me konsultimin publik dhe realizimin e indeksit, lidhur me frekuencën dhe cilësinë e konsultimeve publike.

Grafik 16 – Progresi në realizimin e indeksit të cilësisë së procesit në nivel krahasueshmërie



13. Shkalla e realizmit të planit vjetor të konsultimit publik


Bazuar në urdhrin nr.3, datë 29.1.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e udhëzuesit të konsultimit publik”, parashikohet hartimi i planeve vjetore të konsultimit publik sektorial dhe planit të përgjithshëm vjetor të konsultimit publik, bazuar në procesin e vlerësimit të akteve për konsultim publik, sipas përcaktimeve në ligjin nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Plani vjetor i konsultimit publik 2024 është hartuar në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë së Kryeministrit, sipas hapave të parashikuar në udhëzim dhe dokumenti i konsoliduar është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në afatin e caktuar.

Në planin vjetor të konsultimit publik janë planifikuar 87 projektakte dhe projektvendime, nga të cilat në gjashtëmuorin e parë të vitit 2024 janë konsultuar dhe miratuar 26 prej tyre, ose 30 % e totalit të akteve.

Të dhënat tregojnë rritje të kulturës institucionale lidhur me konsultimin publik, duke funksionuar në mënyrë më transparente, llogaridhënëse dhe të përgjegjshme. Kjo vërtetohet nga fakti që aktet e paplanifikuara i nënshtrohen procesit të konsultimit publik.

Grafik 17 – Konsultimi i akteve të parashikuara në planin vjetor të konsultimit publik 2024



14. Përdorimi i Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik

Në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik aktet e konsultuara dhe miratuara përgjatë vitit 2024, **u shikuan nga 21,665 vizitorë, mesatarisht 750 shikime për akt.**

RENJKP ka shërbyer si një instrument kryesor për procesin e konsultimit publik duke mundësuar rritjen dhe intensifikimin e ndërveprimit ndërmjet aktorëve të shoqërisë civile, komunitetit të biznesit, akademisë, medias dhe qytetarëve me institucionet qendrore politikbërëse.

Publikimi në mënyrë efektive i informacionit për konsultim publik, ka nxitur gjithashtu dërgimin e komenteve dhe reagimeve nëpërmjet komunikimit me e-mail apo shkresor ndërmjet palëve të interesuara dhe institucioneve shtetërore.

Për aktet e miratuar bë gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 u dërguan 15 komente nëpërmjet RENJKP.

15. Gjetjet kryesore dhe rekomandimet

Gjetjet kryesore:

1. Indeksi i frekuencës së konsultimit publik për vitin 2023 është **93,75%**. Më i larti i shënuar ndonjëherë për këtë proces.
2. Indeksi i cilësisë së procesit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 është **7,12** që është treguesi maksimal i shënuar ndër vite.
3. Vijon trendi rritës i indeksit të cilësisë i cili shënon rritje jo vetëm krahasuar me vitin 2022 (**14%**) por edhe me vitin 2023.
4. **945** palë interesi u angazhuan në procesin e konsultimit publik për **30** aktet e miratuara dhe konsultuara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024.
5. **450** komente dhe reagime u dërguan nga palët e interesit, për konsultimin e 30 projektakteve, me një shkallë pranimi **51%**.
6. Indeksi i frekuencës së organizimit të takimeve publike (IPM) është **72,41%**.
7. Raportet e rezultateve të konsultimit publik për aktet e konsultuara u publikuan në masën **100%**.
8. **21,665** është shikueshmëria në Rregjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, për **29** aktet e publikuara në gjashtëmujorin e parë 2024.
9. **97 %** e akteve të konsultuara u publikuan në RENJKP.
10. **100%** e akteve objekt i Vlerësimit të Ndikimit Rregullator, i janë nënshtruar procesit të konsultimit dhe **30%** e raporteve VNR janë ripunuar bazuar në informacionin dhe të dhënat e marra gjatë konsultimit publik.

Konkluzione:

1. Procesi ka shënuar përmirësim të mëtjshëm në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, duke arritur rezultatet më të larta lidhur me realizimin e frekuencës së konsultimeve dhe indeksit të cilësisë së procesit.

2. Konstatohet një kulturë në rritje e llogaridhënies nga institucionet qendrore politikbërëse, e cila ka vijuar paralelisht me rritjen e reagueshmërisë duke publikuar plotësisht të gjitha raportet e konsultimit publik për çdo akt të konsultuar.
3. RENJKP ka funksionuar si një platformë kryesore për procesin e konsultimit publik, por njëkohësisht janë promovuar edhe metodat e tjera të konsultimit publik si tryezat konsultative.
4. Mekanizimi i kontrollit të cilësisë dhe raportimit të rezultateve me qasje jo vetëm statistikore ka rezultuar efektiv duke kontribuar në rritjen e indekseve kryesore për procesin.

Rekomandime

1. Vijimi i forcimit të kapaciteteve të rrjetit të koordinatorëve të konsultimit publik në ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë së Kryeministrit.
2. Promovim dhe nxitje e mëtejshme e procesit.
3. Rritja e ndërgjegjësimit për pjesëmarrje në proces të komunitetit akademik, shkencor dhe biznesit.

Shtojcë- Pasaporta e treguesve për monitorimin e progresit në zbatimin e standardeve të procesit të konsultimit publik në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024.

Pasaporta e treguesve për monitorimin e progresit në zbatimin e standardeve të procesit të konsultimit publik		
		TREGUESI 1
1	Treguesi	Indeksi i frekuencës së konsultimit publik për projektligjet dhe strategjitë
2	Lloji i treguesit	Produkti
3	Referenca e lidhur me dokumentet/ strategjitë strategjike	Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2015-2020
4	Referenca e lidhur me SKZHI	Lidhur me shtyllën: Qeverisja e Mirë & Demokracia dhe Sundimi i Ligjit
5	Referencë e lidhur me qëllimin e politikës së Dokumentit të Strategjisë	Objektivi 2 i Strategjisë së Reformës së Administratës Publike 2015-2020
6	Qëllimi i politikës	Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit
7	Objektivi specifik	Sistemi transparent dhe gjithëpërfshirës i hartimit të ligjeve, i cili bazohet në politikat dhe, i cili siguron përafrimin me acquis
8	Treguesi / masa	Sasior
9	Burimi i shërbimit për monitorimin e treguesve të performancës	Raporti vjetor i qeverisë qendrore për konsultimet publike, raportet vjetore të ministrive të linjës, Regjistri Elektronik i Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, faqet e internetit të ministrive të linjës
10	Institucionet përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave	Departamenti i Akteve Ligjore Prioritare të Këshillit të Ministrave
11		
12	Metodologjia	Ky tregues mat frekuencën e konsultimeve publike duke llogaritur përqindjen e projektligjeve, dokumenteve strategjike dhe politikave (që kërkohej të paraqiteshin për konsultim publik) të miratuara nga Qeveria, të cilat kanë kaluar përmes konsultimeve publike. Metodologjia bazohet në mbledhjen e të dhënave sasiore nga ZKM bazuar në raportimin administrativ të ministrive të linjës për konsultimet publike të kryera, si dhe bazuar

		në të dhënat e mbledhura përmes Regjistrit Elektronik, faqeve të internetit të ministrive të linjës, Sekretariatit të Përgjithshëm (për aktet e miratuara nga Qeveria) si dhe Fletorja Zyrtare.
13	Frekuenca e matjes	Vjetore dhe gjysmëvjetore
14		Gjysmëvjetore
15	Treguesi / Natyra e treguesit: Kumulative/Në rritje	Në rritje
16	Treguesit agregat	
17	Formula e llogaritjes (Jepet formula për mënyrën e llogaritjes së vlerës së këtyre treguesve)	<p>Formula e mëposhtme e llogaritjes përdoret për Indeksin e frekuencës së konsultimit publik (IFPC) për projektligjet dhe strategjitë (IFPC = Përqindja e projektligjeve, dokumenteve strategjike dhe politikave të miratuara nga Qeveria të cilat kanë kaluar përmes konsultimeve publike) - duke përjashtuar ato akte që përjashtohen sipas nenit 4 të Ligjit për konsultimet publike.</p> <p>Numri i projektligjeve, dokumenteve strategjike dhe politikave që kanë kaluara përmes procesit të konsultimit publik në një vit</p> $IFPC = \frac{\text{Numri i projektligjeve, dokumenteve strategjike dhe politikave të miratuara nga qeveria që kërkohej të paraqiteshin për konsultim publik}}{\text{Numri i përgjithshëm i projektligjeve, dokumenteve strategjike dhe të politikave të miratuara nga qeveria që kërkohej të paraqiteshin për konsultim publik}} \times 100$ <p>Perlllogaritja: 30 akte të konsultuara nga 32 akte të miratuara objekt i KP 30/32*100=93.75%</p>
18	Ndarja e të dhënave (Treguesit agregat)	
19		
20		
22	Baza fillestare	2018
		47.23%
		2019
		71.42%
		2020
23		79.57%
		2021 (gjashtë-mujori i parë)
		72.2%
		2021 vit i plotë
		65.9%

		2022 (gjashtë-mujori i parë)
		60.0%
		2022 vit i plotë
		81,63%
		2023 (gjashtë-mujori i parë)
		97.0%
		2023 vit i plotë
		92.0%
		2024 (gjashtëmujori i parë)
		93.7%
25		2021/ Trendi në rënie
26		2022/ Trend konstant
		2023/ Trendi në rritje
		2024/ Trendi në rritje
27	Vlera e rishikuar/ Synimet	Viti / Vlera
28	Vlera / Synimet	Viti / Vlera
29	Referenca e Qëllimeve të ZHvillimit të Qëndrueshem (QZHQ)	16.7 Siguroni vendimmarrje të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet 16.6 Zhvillimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet
30	Fushat e lidhura me standardet e tjera	/

Pasaporta e treguesve për monitorimin e progresit në zbatimin e standardeve të procesit të konsultimit publik

		TREGUESI 2
1	Treguesi	Numri i konsultimeve publike të organizuara për projektligjet me VNR
2	Lloji i treguesit	Produkti

3	Referenca e lidhur me dokumentet/ strategjitë strategjike	Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2015-2020
4	Referenca e lidhur me SKZHI	Lidhur me shtyllën: Mirëqeverisja & Demokracia dhe Sundimi i Ligjit
5	Referencë e lidhur me qëllimin e politikës së Dokumentit të Strategjisë	Objektivi 2 i Strategjisë së Reformës së Administratës Publike 2015-2020
6	Qëllimi i politikës	Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit
7	Objektivi specifik	Sistemi transparent dhe gjithëpërfshirës i hartimit të ligjeve, i cili bazohet në politikat dhe, i cili siguron përafrimin me acquis
8	Treguesi / masa	Sasior
9	Burimi i shërbimit për monitorimin e treguesve të performancës	Raporti vjetor i qeverisë qendrore për konsultimet publike, raportet vjetore të ministrive të linjës, Regjistri Elektronik i Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, faqet e internetit të ministrive të linjës
10	Institucionet përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave	Departamenti i Akteve Ligjore Prioritare të Këshillit të Ministrave
11		
12	Metodologjia	Ky tregues mat numrin e konsultimeve publike të mbajtura për projektligjet me VNR dhe përqindjen e projektligjeve me VNR që kaluan përmes konsultimeve publike nga numri i përgjithshëm i projektligjeve me VNR. Metodologjia bazohet në mbledhjen e të dhënave sasiore nga ZKM bazuar në raportimin administrativ të ministrive të linjës në konsultimet publike të kryera, si dhe bazuar në të dhënat e mbledhura përmes Regjistratit Elektronik, faqeve të internetit të ministrive të linjës, Sekretariatit të Përgjithshëm (për aktet e miratuara nga Qeveria) si dhe Fletores Zyrtare
13	Frekuenca e matjes	Vjetore dhe gjysmëvjetore
14		Vjetore

15	Treguesi / Natyra e treguesit: Kumulative/Në rritje	Në rritje
16	Treguesit agregat	/
17	Formula e llogaritjes (Jepet formula për mënyrën e llogaritjes së vlerës së këtyre treguesve)	Formula e mëposhtme e llogaritjes përdoret për të matur rritjen e konsultimeve publike të mbajtura për projektligjet me VNR (si përqindje e të gjithë projektligjeve të përgatitura me VNR): Numri i projektligjeve të konsultuar me VNR në një vit $IVNR = \frac{\text{Numri i projektligjeve të konsultuar me VNR}}{\text{Numri i përgjithshëm i projektligjeve të përgatitura me VNR}} \times 100$ Përlllogaritja: 20 projektligje me VNR janë konsultuar nga 20 projektligje për të cilat duhej të përgatitej VNR 20/20 *100=100%
18	Ndarja e të dhënave (Treguesit agregat)	/
19		/
20		/
22	Baza fillestare	2020
23		82.60%
		2021 (gjashtë-mujori i parë)
		75%
		Viti 2021
		61%
		2022 (gjashtë-mujori i parë)
		75%
		2022 vit i plotë
		100%
		2023 (gjashtë-mujori i parë)
		95%

		2023 vit i plotë
		100%
		2024 (gjashtë-mujori i parë)
		100%
24	Vlera / Synimet	2021 / Trendi në rënie
25		2022/ Trend në rritje
26		2023/ Trendi konstant
		2024/Trendi konstant
27	Vlera e rishikuar/ Synimet	/
28	Vlera / Synimet	/
29	Referenca e Qëllimeve të ZHvillimit të Qëndrueshem (QZHQ)	16.7 Siguroni vendimmarrje të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet 16.6 Zhvillimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet
30	Fushat e lidhura me standardet e tjera	/

Pasaporta e treguesve për monitorimin e progresit në zbatimin e standardeve të procesit të konsultimit publik

		TREGUESI 3
1	Treguesi	Indeksi i përdorimit të kriterëve të përjashtimit/përjashtimeve nga konsultimet publike për akte në Programin Analitik
2	Lloji i treguesit	Produkti

3	Referenca e lidhur me dokumentet/ strategjitë strategjike	Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2015-2020
4	Referenca e lidhur me SKZHI	Lidhur me shtyllën: Mirëqeverisja & Demokracia dhe Sundimi i Ligjit
5	Referencë e lidhur me qëllimin e politikës së Dokumentit të Strategjisë	Objektivi 2 i Strategjisë së Reformës së Administratës Publike 2015-2020
6	Qëllimi i politikës	Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit
7	Objektivi specifik	Sistemi transparent dhe gjithëpërfshirës i hartimit të ligjeve, i cili bazohet në politikat dhe, i cili siguron përafrimin me acquis
8	Treguesi / masa	Sasior
9	Burimi i shërbimit për monitorimin e treguesve të performancës	Raporti vjetor i qeverisë qendrore për konsultimet publike, raportet vjetore të ministrive të linjës, Regjistri Elektronik i Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, faqet e internetit të ministrive të linjës
10	Institucionet përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave	Departamenti i Akteve Ligjore Prioritare të Këshillit të Ministrave
11		

12	Metodologjia	<p>Ky tregues mat frekuencën e përdorimit të përjashtimeve nga konsultimet publike (kriteret e përjashtimit të përmendura në nenin 4 të Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin publik) për aktet e parashikuara në planin vjetor legjislativ të Qeverisë (Programi Analitik).</p> <p>Kjo matet si përqindje e akteve të parashikuara në Programin Analitik për të cilat janë përdorur përjashtime nga konsultimet publike (kriteret e përjashtimit nga neni 4). Përjashtimet nga konsultimet publike (kriteret e përjashtimit për aktet që nuk kërkohen të konsultohen) përcaktohen në nenin 4 të Ligjit, duke përcaktuar që dispozitat e ligjit nuk zbatohen gjatë proceseve të vendimmarrjes në lidhje me:</p> <p>a) çështjet e sigurisë kombëtare, për sa kohë që ato përbëjnë një sekret shtetëror, në përputhje me ligjin për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror";</p> <p>b) marrëveshjet ndërkombëtare, marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale;</p> <p>c) aktet administrative individuale dhe aktet normative administrative, përveç rasteve kur me një ligj specifik parashikohet ndryshe;</p> <p>d) aktet normative, me fuqinë e ligjit të miratuar nga Këshilli i Ministrave;</p> <p>d) emergjenca civile;</p> <p>e) raste të tjera të përjashtimit të parashikuara nga ligji.</p> <p>Metodologjia bazohet në mbledhjen sasiore të të dhënave nga ZKM bazuar në raportimin administrativ të ministrive të linjës në konsultimet publike të kryera, si dhe bazuar në të dhënat e mbledhura përmes azhurnimit të Planit Vjetor të Konsultimeve Publike, Regjistrisë Elektronike, faqeve të internetit të ministrive të linjës, Sekretariatit të Përgjithshëm (për aktet të miratuar nga Qeveria) si dhe Fletoret Zyrtare.</p>
13	Frekuenca e matjes	Vjetore dhe gjysmëvjetore
14		Vjetore
15	Treguesi / Natyra e treguesit: Kumulative/Në rritje	Në rënie
16	Treguesit agregat	/

17	Formula e llogaritjes (Jepet formula për mënyrën e llogaritjes së vlerës së këtyre treguesve)	<p>Formula e mëposhtme e llogaritjes përdoret për Indeksin e përdorimit të kritereve të përjashtimit/përjashtimeve nga konsultimet publike për aktet në Programin Analitik (IEXCL-PA)</p> <p>Numri i akteve të parashikuara në Programin Analitik për të cilat janë përdorur përjashtime nga konsultimet publike (kriteret e përjashtimit sipas nenit 4)</p> <p>IEXCL-PA= _____ x 100</p> <p>Numri i përgjithshëm i akteve të parashikuara në Programin Analitik</p> <p>Formula e perlllogaritjes: aktet që janë përjashtuar 167/267 akte total *100= 66,29 %</p>
18	Ndarja e të dhënave (Treguesit agregat)	/
19		/
20		/
22	Baza fillestare	2019
23		/
24	Vlera / Synimet	2020
25		88.68%
		2021 (gjashtë-mujori i parë)
26		71,61%
		Viti 2021
		72,6%
		2022 (gjashtë-mujori i parë)
	72.53%	
	2022 vit i plotë	
	72.53%	
	2023 (gjashtë-mujori i parë)	

		71,36%
		2023 vit i plotë
		71,36%
		2024 (gjashtë-mujori i parë)
		66,29%
		2021 / Trend në rënie
		2022/ Trend konstant
		2023/ Trend konstant
		2024/ Trend në rënie
27	Vlera e rishikuar/ Synimet	
28	Vlera / Synimet	
